



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

#### Komisioni i Apelimit

Nr. 10 Prot

Shkodër, më 14.06.2024

#### VENDIM

#### NR. 4

Komisioni i Apelimit, në mbledhjen e tij të datës 14.06.2024, shqyrtoi ankimimin nr. prot 6, datë 10.06.2024 për vendimin nr.18 datë 07.06.2024 "Për rrëzimin e ankesës së Dr.Arlinda Ymeri" të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve, në të cilën u shqyrtuan si dokumentacion dosja e marrë në dorëzim nga KIZ për kandidaten Dr.Pranvera Kraja, me nr. Prot. 8 të KA dhe vertetimi me nr.prot 9, datë 14.06.2024 pranë KA, lëshuar nga Administratori i USH, nr.prot 1893 datë 04.06.2024.

Baza ligjore për shqyrtimin e Ankimimit:

- Ligji i Arsimit të Lartë nr. 80/2015, neni 45;
- Statuti i Universitetit të Shkodrës neni 33, pika 4;
- Rregullore "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatën Akademik në U.SH", neni 21, pika 2, germa a;

#### KOMISIONI I APELIMIT

Në lidhje me ankesën e znj. Arlinda Ymeri, me nr. protokollit: nr 6, të datës 10.06.2024, drejtuar Komisionit të Apelimit me objekt: ankimimin e vendimit të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve, nr. 18, të datës 07.06.2024 dhe ndryshimin e vendimit nr. 18 të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve dhe pretendimeve nga përfaqësuesi ligjor i zj.Ymeri gjatë mbledhjes nr. prot 3, të mbajtur pranë KA me datë 14.06.2024, duke kërkuar ndër te tjera dhe shfuqizimin e pjesshëm të vendimit nr. 4 datë 04.06.2024 të Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Shkencave të Edukimit, përkatësisht pikës 6 të tij dhe skualifikimin e Dr. Pranvera Kraja, si kandidate për Autoritetin Drejtues të njësisë bazë, Departamenti i Mësuesisë, për shkak të mospërbushjes së kriterëve të parashikuara në nenin 11, pika 6 dhe 33 pika 4 e Statutit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", si dhe Ligji për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor nr.80/2015.

#### KONSTATON

Se pretendimet e Z. Ymeri në lidhje me mospërbushjen e kriterit të vjetërsisë prej pesë vitesh në punë të Zj. Pranvera Kraja, nën gjykimin tonë si anëtarë të KA, bazuar në

dokumentacionin e sipërpërmendur në të cilin vertetohet që Zj. Pranvera Kraja është pedagoge me kohë të plotë prej katër vite dhe pesë muaj nga data 10.01.2020 (viti akademik 2019-2020) dhe nga periudha Janar 2014- Janar 2020 ka sigurime të paguara nga USH, kohë gjatë të cilës Zj. Kraja ka punuar si pedagoge e jashtme pranë USH, janë prova të mjaftueshme për kriteret e konkurimit për Drejtues të Njësisë Bazë, si dhe lënien në fuqi të Vendimit nr 18. të KIZ.

### VENDOSI

1. Rëzimin me vendim unanim të ankesës së Dr. Arlinda Ymeri si të pabazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë nr. 80/2015, Statutin e Universitetit të Shkodrës dhe Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në U.SH".
2. Lënien në fuqi të vendimit nr.18 datë 07.06.2024 të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Komisioni i Apelit

#### Kryetare

Arselida Mashaj




#### Sekretare zevendesuese

Arjeta Anamali



#### Anëtarë

Hajrije Dibra



Sereta Koperaj

Ambra Kokaj